

---

**RECENSIONE**

---

**GAZMEND SHPUZA: "PAGES D'HISTOIRE ALBANAISE (1474-1934)", Shtëpia Botuese "ISIS", Stamboll, 2006, 178 f.**

Në fund të vitit të kaluar në Stamboll doli nga shtypi, libri me studime "Pages d'histoire albanaise (1474-1934)" ("Faqe nga historia shqiptare"), i prof. Gazmend Shpuzës. Libri është vënë në qarkullim nga Shtëpia Botuese "ISIS" e Stambollit, e mirënjohur për botimet kushtuar historisë osmane-turke në gjuhët franceze dhe angleze.

Autori i librit dallohet për veprimtarinë e tij studimore shumë të gjerë të pasqyruar në tituj të shumtë, artikuj dhe recensione, midis tyre dhe në dhjetë libra. Ai ka marrë pjesë aktivisht me referate e kumtesa në mjaft tubime shkencore kombëtare dhe ndërkombëtare në Tiranë, Shkodër, Prishtinë, Shkup, New York, Tuniz, Ankara, Stamboll, Amsterdam, Athinë, Kotorr etj.

Punimet e G. Shpuzës i kushtohen një tematike të larmishme të një periudhe të gjatë të historisë së viseve shqiptare. Por ato kryesisht përqendrohen në studimin e Rilindjes Kombëtare dhe të viteve pas Shpalljes së Pavarësisë. Studimet e prof. Shpuzës janë produkt i një përvoje të gjatë, fryt i kërkimeve sistematike të kryera gjatë disa dekadave në biblioteka dhe arkiva në Shqipëri, në Turqi (Stamboll dhe Ankara), Maqedoni, Kosovë etj., në institucione të pasura me burime arkivore dhe bibliografike të një rëndësie të dorës së parë për historiografinë shqiptare, turke dhe atë ballkanike në përgjithësi. Prandaj realizimi i botimit të vëllimit "Pages d'histoire albanaise (1474-1934)" ("Faqe nga historia shqiptare") i prof. dr. Gazmend Shpuzës nga "ISIS" nuk vjen rastësisht. Ai është fryt i afirmimit të kësaj veprimtarie dhe të këtyre botimeve shkencore jo vetëm brenda vendit, por dhe në botën shkencore të jashtme.

Në përmbledhjen e botuar në gjuhën frënge është përfshirë vetëm një pjesë fare e vogël e kësaj veprimtarie, shkrime të botuara që nga viti 1968 e deri në kohët e fundit. Pra, në të përfshihen dhe punime të botuara

që para afro dyzet vjetësh dhe janë futur në këtë vëllim, përgjithësisht, pa u prekur.

Tematika e studimeve të përfshira në këtë përmbledhje është mjaft e gjerë. Ajo shtrihet në një segment kohor 460-vjeçar, që nga shek. XV e deri në vitet '30 të shekullit të kaluar. Në to preken momentet më të rëndësishme të kësaj periudhe.

Libri paraprihet nga parathënia e pasuar nga nëntë studime. Titujt e tyre shprehin pasurinë dhe larminë tematike të vëllimit që i paraqitet studiuesve dhe lexuesve të huaj: toleranca fetare ndërmjet shqiptarëve; lufta për mbrojtjen e Shkodrës në vitet 1474 dhe 1478-1479; Shemsedin Sami Frashëri dhe vëllezërit e tij në prag të themelimit të Lidhjes Shqiptare të Prizrenit; Shemsedin Sami Frashëri – enciklopedist i madh i kohës së tij; Ismail Qemali dhe xhonturqit; jehona e abrogimit të Kalifatit në Shqipëri; Ataturku dhe marrëdhëniet shqiptaro-turke; Revolucioni kombëtar turk dhe reformat qemaliste, si dhe jehona e tyre në Shqipëri; Shqipëria nga Konferencat Ballkanike në Paktin Ballkanik (1930-1934).

Vëllimi mbyllet me shënime historiografike mbi dy botime të autorëve nga Kosova: Sadullah Brestovci, "Marrëdhëniet shqiptaro-serbomalazeze (1830-1878)", botim i Institutit Albanologjik të Prishtinës, 1963 dhe Zekeria Cana, "Socialdemokracia serbe dhe çështja shqiptare, 1903-1914", Prishtinë, 1986.

Siç shihet, përmbajtja e librit "Pages d'histoire albanaise (1474-1934)" ("Faqe nga historia shqiptare"), në masë të madhe u referohet marrëdhënieve shqiptaro-osmane dhe shqiptaro-turke, të një periudhe historike kur dy popujt që ajo i ndërlidh, turqit dhe shqiptarët, vendosën të ndahen nga e kaluara e tyre dhe t'i shndërrojnë vendet e tyre në shtete modernë.

Toleranca fetare ndërmjet shqiptarëve është argumentuar si një nga format më të larta të bashkëjetesës së besimtarëve të feve të ndryshme në Shqipëri, gjë e rrallë në historinë botërore. Siç argumentohet në punim, ajo ka mbijetuar e madje dhe ka lulëzuar nën sundimin e Perandorisë së sulltanëve kalifë, në kushtet e zbatimit të sistemit osman të mileteve, një sistem mjaft liberal, i pranuar dhe sot si i tillë.

Momentet e marrëdhënieve dhe të bashkëpunimit midis popullit turk dhe popullit shqiptar në kohët e reja janë shpalosur përmes trajtesave kushtuar veprimtarisë së Shemsedin Sami Frashërit pas Krizës Lindore të viteve '70 të shek. XIX dhe bashkëpunimit të Ismail Qemalit me xhonturqit në fillim të shek. XX. Me shumë interes është parashtrimi i

kontributit të Samiut si enciklopedist i madh i kohës së tij, i mbështetur në një interpretim shkencor të konceptit qytetërim dhe të zhvillimit historik të tij. Në veprën e tij madhore “Kamus-yl-alam” turkologu ynë i madh, i zhveshur nga fanatizmi fetar e etnik, militon në radhët e para të shkencës moderne të kohës së vet, për të vënë në pah ndihmesën e popullsisë të Lindjes me kulturën e tyre të lartë, në përparimin e qytetërimit botëror në momente vendimtare të zhvillimit të tij.

Një vend të rëndësishëm në punimet e vëllimit zë, jo rastësisht, trajtimi i marrëdhënieve shqiptaro-turke në vitet ‘20-‘30 të shekullit të kaluar dhe në mënyrë të veçantë, jehona e Revolucionit Kombëtar Turk dhe e Reformave qemaliste në Shqipëri. Autori ndalet në trajtimin e jehonës së abrogimit të Kalifatit në Shqipëri, duke e parë atë të lidhur ngushtë me zhvillimet përkatëse në vend para se Asambleja e Madhe e Turqisë të merrte vendimin e saj historik për mënjanimin e qendrës botërore të islamizmit. Kongresi Mysliman i mbajtur në Tiranë disa muaj më parë, më 1923, shpalli mëvetësinë e xhamisë shqiptare nga Kalifati.

Vëllimi mbyllet me një punim kushtuar qëndrimit mjaft aktiv që mbajti Shqipëria e mbretit Zog në Konferencat Ballkanike (1930-1934), përkundrejt politikës jo realiste që mbajtën shtetet ballkanike ndaj saj, duke mos e ftuar të merrte pjesë në nënshkrimin e Paktit Ballkanik.

Prof. Shpuza me këtë botim ka hedhur një hap në drejtimin e duhur, në rrugën që dikton publikimin e studimeve dhe arritjeve të historiografisë shqiptare edhe në gjuhë të huaja.

Nisma e Botimeve ISIS, e drejtuar nga zoti Sinan Kunalalp, me anën e vënies në qarkullim të vëllimit “Faqe nga historia shqiptare (1474-1934)” të prof. Shpuzës, vjen të pasurojë botimet sporadike të teksteve të historisë së Shqipërisë në frëngjisht të realizuara para 45 dhe 35 vjetësh në Tiranë dhe në Paris me angazhimin apo bashkëpunimin e drejtë të institucioneve botuese dhe shkencore të Shqipërisë.

Shpresohet se ky botim do të pasohet dhe me botime të tjera të historianëve tanë, të cilat do të lejojnë ballafaqimin e mëtejshëm të arritjeve dhe të pikëpamjeve.

**Marenglen VERLI**

